



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SH.P.K.

Nr. 75 Prot.
Nr. Dosje 1552

Tiranë, më 06/01/2021

URDHËR

"Për vendosjen e sekuestros mbi kuotat e debitorit"

Drejtuar: **QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT, TIRANË**

Për dijeni: **KOMBI SHPK - Nipt K63026404B (Subjekti Televiziv TV KOMBI)**
Adresë: Rr e Dibrës, Kompleksi Halli, dyqan nr 3, ose Kompleksi Gold, Bar "La Luna", Tiranë

Unë Armels Lole përmbarues gjyqësor pranë Shoqërisë CORRECTOR sh.p.k., pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr. 1552, bazuar në Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë – Nr. 4396 Vendim, datë 18/06/2019,

KONSTATOVA:

Se më datë 17/12/2020 është lidhur kontrata e shërbimit midis shoqërisë përmbarimore Corrector sh.p.k dhe kreditorit Tranzit Shpk, me objekt ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv – Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 4396 Vendim, datë 18/06/2019 me palë dhe objekt:

- **Kreditor:** Tranzit shpk (Kontrate datë 21/10/2016)
- **Debitorë:** TV KOMBI SHPK me Nipt:K63026404B
- **Objekti:** Pagesë detyrimi

Për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit, duhet të kryhet vënia e sekuestros mbi çdo pasuri të debitorit me qëllim shlyerjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Për sa më sipër, si dhe në zbatim të neneve 519, 527, 560, 563 e në vijim të K.Pr.Civile si dhe të Ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJ:

1. Vendosjen e sekuestros mbi subjektin:

- **TV KOMBI SHPK me Nipt:K63026404B, me Seli: Lagjja Bishanak, Rr Skenderbeu, Fier.**

duke ndaluar disponimin ose tjetërsimin e kuotave të debitorit, si dhe ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga këto kuota;

2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor;
3. Për personat që bëhen pengesë, do të aplikohet sanksioni i gjobës në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzimi për ndjekje penale në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi.

SHOQËRIA "CORRECTOR" SHPK
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ARMELS LOLE

